

SHPLLJE E VENDIT TË LIRË TË PUNËS

Titulli i vendit të punës: Personel i Sigurisë Fizike (3 pozita)

Grada e pozitës: D13

Kohëzgjatja e punësimit: me afat të pacaktuar

Divizioni: Siguria Fizike

I raporton: Udhëheqësit të Divizionit të Sigurisë Fizike

BQK inkurajon të gjithë të interesuarit që të aplikojnë për këto pozita pavarësisht gjinisë!

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Të jetë vigjilent në mbrojtjen e pasurisë dhe personelit të BQK-s gjatë tërë kohës në detyrë;
- Të jetë i kujdesshëm dhe të ketë vetiniciativë në organizimin e pengimit të çfarëdo rreziku që mund t'i kanoset objektit dhe personelit të BQK-s;
- Të raportojë menjëherë për rastet të cilat paraqesin rrezik eventual ose tentimet e veprimeve të pa autorizuara të futjes në objekt etj. duke bashkëpunuar me Policinë e Kosovës;
- Të sigurojë që kushtet dhe rrethanat e sigurisë nuk rrezikojnë personelin e BQK-së, dhe duke respektuar rregullat intervenon në çdo situatë ku punëtori ose vizitori pëson ndonjë aksident, lëndim ose ndonjë humbje të gjësendeve të tyre;
- Të jetë në gjendje t'i kuptojë dhe t'i shfrytëzojë të gjitha pajisjet elektronike të sigurisë, si: sistemin e vëzhgimit me kamera, alarmet, etj. dhe të sigurojë të gjitha hapësirat brenda dhe jashtë objektit;
- Të sigurojë që evidencat për çfarëdo rasti apo incidenti të mbesin të paprekura deri të arrijnë autoritetet për hulumtimin e tyre;
- Të kontrollojë në mënyrë të vazhdueshme funksionimin e pajisjeve elektronike të cilat shërbejnë për sigurinë – të raportojë menjëherë tek udhëheqësi i DSF-së për çdo parregullsi të vërejtur;
- Ta kuptojë Politikën e Sigurisë Fizike të BQK-së, vendimet ekzekutive dhe urdhëresat administrative lidhur me sigurinë fizike, dhe t'iu përmbahet me përpikëri atyre;
- T'iu përmbahet me përpikëri rregullores rreth punëve të përditshme të njësisë së sigurisë fizike;
- Të zbatojë të gjitha kërkesat lidhur me sigurinë të dhëna nga Udhëheqësi i Divizionit të Sigurimit dhe Bordi Ekzekutiv i BQK-s.

Edukimi dhe kualifikimi:

- Shkollim i mesëm i lartë sipas legjislacionit në fuqi;
- Certifikimet nga organet e sigurisë apo mbrojtjes konsiderohen përparësi;
- Shkathësi të mira komunikimi;
- Njohuria për përdorimin e kompjuterit është përparësi.

Përvoja e punës:

- Së paku 3 vite përvojë në fushën e sigurisë fizike;

Të gjithë kandidatët duhet të dërgojnë dokumentet e mëposhtme:

- Aplikimet me mosplotësim të plotë dhe korrekt të **Formularit zyrtar të BQK-së** gjatë aplikimit online nuk do të merren në shqyrtim dhe rezultojnë me diskualifikim gjatë procesit të përzgjedhjes.
- Kandidatët duhet të bashkëngjisin **letër përcjellëse (motivuese)**, e cila duhet të jetë e adresuar dhe e përgatitur posaçërisht **për pozitën për të cilën aplikojnë**; në të kundërtën, aplikimi nuk do të merret në shqyrtim;
- **Dëshmi mbi përvojën e punës**, që mbulojnë **së paku tre (3) vite** përvojë pune (kopje të kontratave të punës, vërtetime nga punëdhënësi apo dokumente të tjera relevante që dëshmojnë pozitën e mbajtur dhe përvojën e punës, pa cenuar aktet relevante për mbrojtjen e të dhënave personale).
- **Raporti nga Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës (Trusti)** për periudhën përkatëse, që mbulon së paku tre (3) vite përvojë pune, ose, në rastet kur raporti nga Trusti nuk aplikohet ligjërisht, vërtetim tatimor nga Administrata Tatimore e Kosovës (ATK);
- Kopjet e diplomave, ndërsa diplomat e fituara jashtë Republikës së Kosovës duhet të jenë të njohura /nostrifikuara zyrtarisht nga ana e MASHT-it;
- Dëshmi mbi identitetin/kopja e letërnjoftimit që shërben për të vërtetuar shtetësinë e Kosovës.

Procedura e aplikimit:

- Afati i fundit për aplikim është **23 korrik 2026**.
- Aplikimi mund të bëhet online (<https://hris.bqk-kos.org>) përmes faqes zyrtare
- të BQK-së. Format tjera të aplikimit nuk do të merren parasysh